

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Abstrakti

“SFIDAT E ZBATIMIT TE LEGJISLACIONIT PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUARA NE REPUBLIKEN E KOSOVES”

Mentori: Prof. Ass. Dr. Flamur Hyseni

Kandidati : Gentrit Zeqiri

Në këtë punim trajtohen sfidat e zbatimit të legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës duke ju nënshtruar një analize të detajuar se sa janë të rregulluar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës dhe sa i shfrytëzojnë këto të drejta duke mos anashkaluar as faktin se sa këto të drejta zbatohen nga ana e institucioneve të cilat janë të obliguara për ti zbatuar këto të drejta edhe pse ligjet në fuqi garantojnë përfshirjen e tyre në institucionet e Republikës së Kosovës.

Objekt studimi në këtë punim jenë të gjitha ligjet që janë të aplikueshme në vendin tone me të cilat rregullohen liritë dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, janë trajtuar edhe rastet e veçanta të kësaj kategorie , udhëzimet administrative të nxjerra dhe aktet tjera administrative që mundësojnë zbatimin e ligjit

Po ashtu është trajtuar edhe konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara edhe pse nuk është e zbatueshme dhe ende nuk është e inkorporuar në kushtetutën tone si pjesë e legjislacionit tone , është hulumtuar historiku i kësaj konvente pastaj janë trajtuar raste e disa shteteve me të cilat kjo konventë është e zbatueshme si dhe të drejtat dhe detyrimet e shteteve përkatëse përmes kësaj konvente

Fjalët kyçe : Personat me aftësi të kufizuara , Republikën e Kosovës , Ligjet ,Të drejtat , Respektimi , Zbatimi, Konventa

